

**DEKLARATË E ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I  
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-ut LIDHUR  
ME DEBATIN E KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR UNMIK-un**

**Nju Jork**

**27 shkurt 2017**

Z. Kryetar, shkëlqesitë e juaja,

Para dhënies së komenteve të mia për gjendjen në Kosovë, dëshiroj të shpreh pikëllimin tim të thellë për vdekjen e ambasadorit të Federatës së Rosisë, Vitali Qurkin. Me këtë rast i shpreh ngushëllimet e mia të sinqerta bashkëshortes dhe familjes së tij, si dhe Qeverisë së Federatës së Rosisë për humbjen e njërit prej diplomatëve më të mëdhenj të vendit. Prania e tij në Këshill do të na mungojë.

Z. Kryetar,

Siç është cekur në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, muajt e kaluar janë karakterizuar me përparim të herëpashershëm, si dhe me tensione të rritura mes Beogradit dhe Prishtinës, duke përfshirë edhe një numër reagimesh dhe kundëreagimesh të ndërsjella, të cilat nganjëherë përcilleshin edhe me retorikë kërcënuese e luftënxitëse. Ngjarjet dhe pozicionimet politike zvogëlojnë hapësirën për përparime në dialogun e nivelit të lartë politik, proces ky që mbetet sa i brishtë, aq edhe thelbësor dhe i pazëvendësueshëm.

Gjatë diskutimeve të mia të fundit në Prishtinë dhe Beograd, secila palë natyrisht se ka shprehur perceptime të ndryshme për arsyet e cilësisë së

dobësuar të komunikimeve dhe marrëdhënieve, dhe në përgjithësi kanë akuzuar njëra-tjetrën për provokime të qëllimshme. Udhëheqësit e Prishtinës perceptojnë veprimet dhe fjalët e ndryshme të Beogradit si të llogaritura për cenimin e objektivave të Qeverisë së Prishtinës, posaçërisht lidhur me përpjekjet e saj për bashkëpunim me komunat veriore të banuara me shumicë serbe. Udhëheqësit e Beogradit i perceptojnë veprimet dhe fjalët e Prishtinës si tentim për anashkalimin e procesit të bazuar në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe për krijimin e realiteteve të reja në terren.

Pavarësisht perceptimeve dhe interpretimeve të ndryshme, ishte fakt se rrjedha e ngjarjeve e përshkruar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, u kombinua për të luhatur besimin, për të ngufatur hapësirën për dialog të frytshëm dhe për të çuar gjendjen shumë afër jostabilitetit dhe konfrontimeve të reja. Po ashtu, më duhet të theksoj se që nga shpallja e raportit, kanë ndodhur edhe disa zhvillime të tjera të rëndësishme, duke përfshirë edhe disa më konstruktive.

Në fillim të këtij muaji, pjesërisht si reagim ndaj gjendjes përshkallëzuese, udhëheqësit e Beogradit dhe Prishtinë më në fund u takuan në nivelin më të lartë politik në Bruksel me Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë. Ky takim ishte hap thelbësor për gjetjen e rrugëdaljes nga gjendja përkeqësuese dhe për të rikonfirmuar publikisht përkushtimin e tyre për bashkëpunim.

Pak ditë më vonë, pas konsultimeve të ngushta të udhëhequra nga Përfaqësuesja e BE-së, ku u përfshinë edhe partnerë të tjerë diplomatik, kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut dhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i Kosovës nënshkruan marrëveshjen për heqjen e murit, i cili ishte ndërtuar si pjesë e planit për rirregullimin e urës afër skajit verior të urës së Mitrovicës.

Rrjedhimisht, muri u rrënuar pa ndonjë incident më datën 5 shkurt, dhe më pas ka filluar ndërtimi sipas planit hapësinor të ri të dakorduar, ku merren parasysh shqetësimet e të gjitha palëve me interes.

Kohëve të fundit Prishtina ka rifilluar thirrjet për transformimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, duke përfshirë edhe miratimin e rezolutës nga Kuvendi i Kosovës. Kjo iniciativë vazhdon të kundërshtohet nga serbët e Kosovës dhe Beogradi, duke ju referuar rezolutës 1244, ku theksohet roli ekzekutiv dhe autoriteti i pranisë ndërkombëtare të sigurisë, KFOR-it.

Këtë nismë vazhdojnë ta kundërshtojnë serbët e Kosovës dhe Beogradi, por gjithashtu duhet të theksohet qartësia e rolit dhe autoritetit ekzekutiv sipas Rezolutës 1244 lidhur me praninë ndërkombëtare të sigurisë – KFOR-in.

Z. Kryetar,

Jehona e efekteve të tensioneve të fundit në Kosovë është ende e pranishme. Besimi në mes të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës është luhatur dhe do të merr kohë për t'u rifituar. Pavarësisht kësaj, me rifillimin e dialogut të nivelit të lartë, ka shenja se puna prapë ka filluar drejt arritjes së këtij qëllimi: diskutimi i hollësive rreth zbatimit të Bashkësisë/Asociacionit të ardhshëm të komunave me shumicë serbe, me siguri se do t'u ndihmojë serbëve të Kosovës që të ripërfshihen në aktivitete të qeverisë, nga të cilat fatkeqësisht gjatë tre muajve të kaluar kanë vendosur të largohen.

Siç ka ndodhur në të kaluarën, qasjet apo hapat e njëanshëm që kanë për qëllim zgjidhjen e çështjeve që prekin të dyja palët, dhe në fakt përparimin e

përgjithshëm në procesin e normalizimit, kanë më shumë gjasa që të çojnë në konfrontime sesa në rezultate pozitive në drejtimin e dëshiruar prej atyre që konsiderojnë ndërmarrjen e hapave të tillë.

Dialogu nuk ka alternativë. Instruksionet ndërkombëtare të parapara për Prishtinën dhe Beogradin janë imperativë kategorikë, dhe përfshijnë: moskonfrontimin, zgjidhjen e çështjeve përmes dialogut dhe vendosjen e objektivit të përmirësimit të jetës së njerëzve para kalkulimeve të kufizuara dhe të ngushta. Shpresoj që ky Këshill do të ndihmojë që udhëheqësit ta mbajnë fjalën e tyre dhe ata të kenë përkushtim të sinqertë e konsekuent ndaj dialogut deri në realizimin e plotë të të gjitha marrëveshjeve tanimë të arritura, si dhe t'i shmangen dhënies së deklaratave apo ndërmarrjes së aktiviteteve që rrezikojnë potencialin e dialogut dhe të gjitha përparësitë që është paraparë t'ia sjell popullatës, pra, sigurinë, prosperitetin dhe paqen.

Z. Kryetar,

Institucionet e Kosovës vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha në plotësimin e objektivave ashtu siç mund të dëshirojnë liderët e tyre. Lufta e brendshme vazhdon. Polemikët në mes të qeverisë dhe opozitës vazhdojnë të jenë të ashpra. Mosmarrëveshjet në mes të partive qeverisëse janë gjithashtu të dukshme, siç është mospajtimi edhe brenda partive qeverisëse. Palët kryesore me interes përballen me presione për të pozicionuar veten e tyre në ciklet elektorale, shumë shpesh duke e paguar me kohë dhe energji që mund t'i kushtohet qeverisjes. Beogradi është gjithashtu i angazhuar në fushatë politike lidhur me zgjedhjet presidenciale në prill. Është shumë e rëndësishme të sigurohet që politikët elektorale të mos dëmtojnë proceset dhe progresin jetik; atë progres që ndërtohet vetëm me kohë të gjatë dhe përpjekje të pandërprera,

përtej lëkundjeve të arsyeve politike. Normalizimi i marrëdhënieve, pajtimi dhe drejtësia të gjitha i përkasin këtij horizonti të gjerë.

Suksesi në normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës është i ndërlidhur me pajtimin shoqëror afatgjatë e të qëndrueshëm në mesin e komuniteteve të Kosovës. Lidërsip i guximshëm dhe hapa pozitivë janë të rëndësishëm për promovimin e ndryshimit të qëndrimeve. Ne i mirëpresim dhe i vlerësojmë disa hapa të rëndësishme të ndërmarra nga disa liderë, dhe inkurajojmë përpjekjet e vazhdueshme që të tejkalojmë të kaluarën dhe të përqendrohemi tek e ardhmja.

Së bashku me të gjithë kolegët e mi ndërkombëtarë në Kosovë, i kushtova vëmendje të duhur iniciativës për të shqyrtuar krijimin e një komisioni për të vërtetën dhe pajtimin, si një mekanizëm shtesë për hapjen e dialogut të brendshëm në mes të komuniteteve në Kosovë. Çfarëdo initiative e tillë duhet vlerësuar dhe duhet dhënë përkrahje sa më e madhe sipas nevojës për të inkurajuar suksesin. Është po ashtu e rëndësishme të përkujtojmë se iniciativat e tilla janë pjesë e një tërësie më të madhe: vetë dialogu i mundësuar nga BE-ja është gjithashtu një pjesë, siç është edhe puna e rëndësishme konstante për t'u kujdesur për viktimat e shumta të konfliktit në Kosovë të cilët akoma presin drejtësinë. Në mesin e parimeve dhe praktikave më esenciale ndërkombëtare për drejtimin e proceseve të së vërtetës dhe pajtimit në rrethana pas konfliktit janë: paanshmëria, pavarësia, transparenca, komplimentariteti me përpjekjet tjera, konsultimi dhe pjesëmarrje e plotë nga të gjithë palët e interesuara të përfshira dhe, përfundimisht, përkushtimi për vëmendje dhe kujdes të duhur të nevojshëm për një proces të tillë kaq të ndjeshëm.

Z. Kryetar,

Puna e shtuar duhet të vazhdojë në mënyrë që të përmirësohet gjendja sociale dhe ekonomike në Kosovë. Trajtimi i papunësisë, arritja e përparimit në sundimin e ligjit dhe luftimi i korrupsionit, akoma janë çështje qendrore për të gjithë njerëzit në Kosovë. Njerëzit të cilët shohin pak shpresë apo perspektivë brenda shoqërisë, ndjehen të zhgënjyer dhe të izoluar. Shumica do të marrin rrugë alternative, duke përfshirë edhe ato që çojnë në radikalizëm religjioz dhe ekstremizëm të dhunshëm. Ashtu siç u theksua në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, kërcënimi nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmit vazhdojnë të jenë aktuale në Kosovë dhe në mbarë rajonin. Puna profesionale nga organet e sigurisë së Kosovës vazhdon, ndërsa integrimi më i mirë në qasjet rajonale dhe ndërkombëtare mund t'i avancojë shumë këto përpjekje. Përmes planit aktual pesëvjeçar të koordinuar me Zyrën e Kryeministrit, autoritetet e Kosovës po ashtu përqendrohen në një qasje gjithëpërfshirëse për këtë çështje, duke përfshirë edhe sferat arsimore dhe zhvillimore. Kjo punë e rëndësishme mund të përfitojë gjithashtu nga përkrahja e fuqishme dhe koordinimi me përpjekjet globale.

Z. Kryetar,

Reagimet dhe angazhimet e koordinuara gjatë periudhës së fundit të tensioneve të shtuara, sidomos me përfshirjen e BE-së, KFOR-it, UNMIK-ut dhe OSBE-së, në mesin e të tjerëve, edhe njëherë konfirmoi rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm ndërkombëtarë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe në rajon. Stabiliteti në Kosovë, normalizimi i marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit, janë pjesë e përpjekjeve më të gjera për rritjen e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.

Javën e kaluar në këtë Këshill, Sekretari i Përgjithshëm theksoi rrezikun nga lëkundja e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Çdo tension apo krizë e mundshme në mes të Beogradit dhe Prishtinës nuk mund të shihet e izoluar nga sfidat me të cilat tanimë përballet rajoni. Marrëdhëniet e mira fqinjësore, përkushtimi për një të ardhme të përbashkët brenda hapësirës së unifikuar evropiane, zotimi për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve vetëm përmes mjeteve paqësore të dialogut dhe kompromisit, janë esenciale për Kosovën ashtu siç janë për tërë rajonin.

Derisa unë kam raportuar para jush gjatë muajve të fundit, UNMIK-u ka bërë një riorganizim të ri në punën e tij, duke ofruar mbështetje relevante aty ku kërkohet më së shumti, dhe punon për të siguruar që palët, proceset politike të përqendruara në BE, dhe të gjithë partnerët tanë organizativ ndërkombëtarë të përfitojnë nga partneriteti i mirë-organizuar dhe i harmonishëm në terren. Duke e bërë këtë, ne jemi mirënjohës për përkrahjen e ngushtë që e marrim nga të gjithë anëtarët e këtij Këshilli.

Unë sinqerisht e falënderoj Këshillin për këtë përkrahje të vazhdueshme.

FUND